



URDHRI I INFERMIERIT
TË SHQIPËRISË

KONGRESI KOMBËTAR I MAMIVE 2025

5 MAJ, 2025 - TIRANË, SHQIPËRI

INOVACIONI DHE LIDERSHIPI PËR
SHËNDETIN E NËNËS DHE TË FËMIJËS

THIRRJE PËR ABSTRAKTE

MAMIA SI FIGURË THELBËSORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR.

KONGRESI KOMBËTAR I MAMIVE

5 MAJ, 2025
TIRANË, SHQIPËRI

KONGRESI I MAMIVE 2025

5 MAJ, 2025

TIRANË, SHQIPËRI



Të nderuar kolegë,

Kam nderin dhe kënaqësinë t'ju ftoj në **Kongresin e Mamive të Shqipërisë**, i cili do të mbahet më **5 Maj 2025**, në **Hotel Tirana International**. Ky event do të bashkojë mamitë dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor nga Shqipëria dhe më gjerë për të ndarë njohuritë, shkëmbyer eksperiencë, për të eksploruar praktika inovative dhe për të krijuar një rrjet më të gjerë profesionistësh të cilët punojnë për të njëjtin qëllim: ofrimin e një kujdesi shëndetësor cilësor ndaj foshnjëve dhe nënave.

Në Shqipëri, mamitë luajnë një rol thelbësor në ofrimin e kujdesit të plotë, të përqendruar te gruaja, nga mbështetja para lindjes, në lindje dhe pas lindjes. Angazhimi ynë për praktika holistike dhe të bazuara në evidenca siguron që nënat të marrin një kujdes cilësor, falë zhvillimit profesional të figurisë së mamive në vendin tonë dhe përshtasin më praktikën dhe protokollin më të mirë ndërkombëtar.

Përmes sesioneve të ndryshme, diskutimeve dhe punimeve shkencore, do të trajtojmë tema kyçe mbi shëndetin riprodhues, mirëqenien e nënave dhe zhvillimet më të fundit në fushën e mamive.

Ky Kongres është gjithashtu një event i diversitetit, fuqizimit dhe rritjes profesionale. Duke përqafuar perspektiva të ndryshme dhe duke mësuar nga njëri-tjetri, ne vazhdojmë të përparojmë në misionin tonë të përbashkët për të përmirësuar kujdesin për nënat dhe të porsalindurit.

Ju ftojme me kënaqësi të na bashkoheni në Tiranë për një event frymëzues dhe të pasur me njohuri. Le të bashkohemi për të formësuar më tej të ardhmen e mamive në Shqipëri!

Me respekt,

Presidenti i Urdhrit të Infermierëve të Shqipërisë

Blerina Duka



Temat që do të trajtohen:

- Zgjedhjet dhe praktikat e lindjes
- Edukimi
- Kompetencat thelbësore për praktikën e mamiisë
- Organizimi dhe lidershipi në mami
- Kujdesi në rastet komplekse dhe patologjitë e kujdesit obstetrik
- Kujdesi pas lindjes
- Kujdesi dhe perspektivat e krijimit të një familjeje
- Cikli riprodhues gjatë jetës
- Mbështetja e shëndetit mendor
- Mbështetja e lindjes normale
- Shëndeti global
- Promovimi i shëndetit

Kush mund të marrë pjesë?

1. Mamië dhe profesionistët e kujdesit kujdesit shëndetësor që ofrojnë kujdes për të porsalindurin dhe gruan

- Mami të licencuara që punojnë në spitale, qendra shëndetësore apo në praktikë të pavarur
- Studente të mamiisë dhe akademikë të fushës
- Mami me role drejtuese dhe menaxheriale

2. Profesionistë të kujdesit shëndetësor

- Obstetër-gjinekologë
- Neonatologë dhe pediatër
- Infermierë obstetrike dhe pediatrie
- Fizioterapistë që punojnë me gratë shtatzëna dhe nënat pas lindjes



- Psikologë dhe specialistë të shëndetit mendor të përfshirë në kujdesin perinatal

3. Akademikë dhe studiues

- Pedagogë dhe studiues në fushën e mamisë, obstetrikës dhe shëndetit riprodhues
- Institucione akademike dhe kërkimore

4. Politikëbërës dhe përfaqësues të organizatave shëndetësore

- Përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve shëndetësore publike dhe private
- Përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që mbështesin shëndetin e nënave dhe foshnjave

5. Studentë dhe profesionistë të rinj

- Studentë të mamisë dhe infermierisë që dëshirojnë të mësojnë nga ekspertët dhe profesionistët e fushës
- Profesionistë të rinj që kërkojnë zhvillim profesional dhe mundësi për network

6. Përfaqësues të sektorit privat dhe teknologjisë në shëndetësi

- Kompani që ofrojnë pajisje mjekësore dhe teknologji për kujdesin e nënave dhe foshnjave

Përse duhet të merrni pjesë?

Pjesëmarrja në këtë Kongres ofron një sërë përfitimesh profesionale dhe akademike për të gjithë ata që janë të përfshirë në kujdesin e nënës, të porsalindurit dhe shëndetin riprodhues.

Disa arsye përse duhet të merrni pjesë:

1. Përditësimi me praktikën dhe inovacionet më të fundit

- Kongresi sjell zhvillimet më të fundit në fushën e mamisë, bazuar në kërkime shkencore dhe praktika ndërkombëtare.



- Diskutohen metodat më të reja për promovimin e lindjes natyrale dhe zvogëlimin e ndërhyrjeve të panevojshme mjekësore.

2. Mundësi për të ndarë dhe shkëmbyer njohuri

- Pjesëmarrësit kanë mundësinë të ndajnë përvojat e tyre dhe të mësojnë nga ekspertët në fusha të ndryshme të kujdesit perinatal.
- Prezantime dhe diskutime mbi sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e kujdesit ndaj grave dhe foshnjeve.

3. Network dhe bashkëpunim profesional

- Kongresi ofron mundësinë për t'u lidhur me profesionistë të tjerë, duke krijuar kontakte të reja dhe mundësi bashkëpunimi.
- Një ambient ideal për të diskutuar përvoja dhe për të ndërtuar marrëdhënie profesionale brenda dhe jashtë Shqipërisë.

4. Zhvillim profesional dhe njohje akademike

- Pjesëmarrësit mund të përfitojnë nga sesione të specializuara që ndihmojnë në zhvillimin e tyre profesional.
- Certifikata pjesëmarrjeje me kredite që mund të shërbejnë për zhvillimin e karrierës dhe edukimin e vazhdueshëm.

5. Adresimi i sfidave të reja në kujdesin e nënave dhe foshnjeve

- Diskutohen temat më aktuale si përfshirja e teknologjisë në kujdesin e grave, të porsalindurit, shëndetin riprodhues, diversiteti dhe përmirësimi i politikave shëndetësore.
- Roli i mamive në mbështetjen e shëndetit mendor, përmirësimin e kujdesit pas lindjes dhe promovimin e një ambienti të sigurt për nënat dhe foshnjat.

6. Inspirim dhe motivim

- Një mundësi për të reflektuar mbi misionin e mamive dhe për të marrë frymëzim nga kolegët dhe liderët në këtë fushë.
- Sesione motivuese dhe diskutime që ndihmojnë në fuqizimin e profesionit të mamisë dhe në promovimin e një kujdesi më të mirë për nënat dhe familjet.

Duke marrë pjesë në Kongresin e Mamive të Shqipërisë 2025, ju do të jeni pjesë e një lëvizjeje të madhe për përmirësimin e shëndetit të nënave dhe foshnjeve, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e këtij kujdesi në Shqipëri dhe më gjerë.

Mos e humbisni këtë mundësi unike për të mësuar, bashkëpunuar dhe kontribuar në të ardhmen e mamisë!

Data të rëndësishme!

Dërgimi i abstrakteve:

Deri në datën 28 Mars 2025

Pranimi i abstrakteve do të njoftohet në rrugë elektronike.

Regjistrimi i pjesëmarrësve online dhe fizikisht pranë Hotel Tirana International.

Abstraktet do të dërgohen në adresën elektronike: events@urdhriinfermierit.org

Eventi është në proces akreditimi nga ASCK.

Abstrakti duhet të dërgohet në formatin word me limit fjalësh nga 300-350 fjale, në gjuhën shqipe dhe angleze.

Abstraktet do të dërgohen në rrugë elektronike në adresën: events@urdhriinfermierit.org

Pranimi i abstrakteve do të njoftohet në rrugë elektronike brenda datës 10 Prill 2025.

Bashkë me dërgimin e abstraktit ju lutem të bashkëngjisni dhe CV e autorit/autorëve korrespondentë.

Punimi duhet të shoqërohet me të dhënat e kontaktit të autorit korrespondent për komunikim (emër dhe mbiemër, profesioni, adresa, vendi i punës, telefon, e-mail).

Abstrakti duhet të jetë në formatin word; shkrimi **Times New Roman 12**, paragrafi **Single**, orientimi **Justified**, hapësira midis rreshtave **1.5**.

- **TITULLI:** Duhet të jetë me shkronja kapitale, *bold*, paragrafi *centered*.
- **AUTORËT:** Duhet të listohen sipas kontributit në punim.
- **HYRJA**
- **OBJEKTIVAT**
- **METODOLOGJIA**
- **REZULTATET**
- **KONKLuzionet**
- **FJALËT KYÇE:** 4-5 fjalë

Për çdo informacion, ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni në:

events@urdhriinfermierit.org